



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL, NDIHMËS EKONOMIKE, STREHIMIT SOCIAL,
BARASIZË GJINORE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT

Nr. 336 prot.

Klos, më 23/01/2024

Lënda: Dërgim Projekt – Vendimi.

Drejtuar: KËSHILLIT TË BASHKISË KLOS

KËTU

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Projekt–Vendimin për vlerën e qirasë mesatare të apartamenteve/banesave për efekt subvencionimi qiraje për vitin 2024.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI I BASHKISË

Valbona Kola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL, NDIHMËS EKONOMIKE, STREHIMIT SOCIAL,
BARASIZË GJINORE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT

Nr. 336 prot.

Klos, më 23/01/2024

Lënda: Dërgim Projekt – Vendimi.

Drejtuar: KËSHILLIT TË BASHKISË KLOS

KËTU

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Projekt–Vendimin për vlerën e qirasë mesatare të apartamenteve/banesave për efekt subvencionimi qiraje për vitin 2024.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI I BASHKISË

Valbona Kola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL, NDIHMËS EKONOMIKE, STREHIMIT SOCIAL,
BARASIZË GJINORE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT

Nr. 336 prot.

Klos, më 23.01.2024

PROJEKT-VENDIM
Nr. ___ prot., datë ___/___/2024

PËR

“ QIRANË MESATARE TË APARTAMENTEVE/BANESAVE, PËR EFEKT
SUBVENCIONIMI QERAJE PËR VITIN 2024”

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës; ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”; Vendimit nr.361 datë 29.05.2019 “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre i strehimit, në rastet e parashikuara në ligj dhe bashkëpunimit institucional”; Vendimit nr. 362, datë 29.05.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”; Vendimit nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe te afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; Vendimit nr. 84, datë 26.12.2023 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.83, Datë 26/12/2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024”, si dhe në studimin e tregut që Komisioni i Strehimit ka bërë për vlerën e qirasë për vitin 2024, i kërkojmë Këshillit Bashkiak të,

VENDOSË:

Miratimin e vlerës së qirasë për apartamentet/banesat, në Bashkinë Klos, për të gjitha kategoritë e strukturave të banesave si më poshtë:

- | | |
|---|------------------|
| 1. Për apartament të tipit “Garsoniere” | 8,000 lekë/muaj |
| 2. Për apartament të tipit 1+1 | 10,000 lekë/muaj |
| 3. Për apartament të tipit 2+1 | 12,000 lekë/muaj |
| 4. Për apartament të tipit 3+1 | 15,000 lekë/muaj |

P/ Sek. të Kujdesit Social, Ndhmës Ekonomike, Strehimit
Social, Barazisë Gjinore dhe të Drejtave të Njeriut

P) Sanije Gjini

Zv/Kryetari i Bashkisë
Adelina Laçi

KRYETARI I BASHKISË
Valbona Kola



RELACION

PËR

“ QIRANË MESATARE TË APARTAMENTEVE/BANESAVE, PËR EFEKT SUBVENCIONIMI QERAJE PËR VITIN 2024”

Në nenin 24 të ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” parashikohet se Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social”, ka për objekt të tij administrimin dhe shpërndarjen e programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim.

Vendimi nr. 384, datë 12.6.2019 “Për Përcaktimin e Dokumentacionit për të Përfiturar Strehim sipas çdo Pogrami Social të Strehimit dhe të Afateve e të Procedurave të Miratimit nga Organet e Vetëqeverisjes Vendore”, ka për qëllim përcaktimin e kriterëve dhe procedurave që duhet të ndiqen për përfitimin e subveconimit të qirasë nga individët dhe familjet në nevojë.

Një formë e programeve të strehimit social është subveconimi i qirasë. Prej disa vitesh Bashkia Klos, përdor këtë program për të mbështetur familjet e pastreha.

Sektorit të Kujdesit Social, Ndhmës Ekonomike, Strehimit Social, Barazisë Gjinore dhe të Drejtave të Njeriut si dhe komisionit të strehimit në Bashki, për shkak të dhënies së subveconimit të qirasë për kategoritë e familjeve në nevojë, të cilat përfitojnë strehim social sipas parashikimeve ligjore, i lind nevoja e përcaktimit të qirasë mesatare për të gjitha kategoritë e strukturave të banesave / apartamenteve të lëshuara me qira. Në nenin 2, pika 36 të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, citohet se “Qira mesatare” është mesatarja e ofertave të qirave, të marra gjatë një viti, në tregun e lirë.

Bazuar në studimin e tregut, vlera e qirasë për apartamentet/banesat, në Bashkinë Klos, për të gjitha kategoritë e strukturave të banesave janë si më poshtë:

1. Për apartament të tipit “Garsoniere”	8,000 lekë/muaj
2. Për apartament të tipit 1+1	10,000 lekë/muaj
3. Për apartament të tipit 2+1	12,000 lekë/muaj
4. Për apartament të tipit 3+1	15,000 lekë/muaj

**P/ Sek. të Kujdesit Social, Ndhmës Ekonomike, Strehimit
Social, Barazisë Gjinore dhe të Drejtave të Njeriut**

P/ Sanije Gjini

